

20220991286

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SOCIALE

##### Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21 dhe 294/21), në nenin 34, në paragrafin 1, pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët “përveç personit që nuk është i evidentuar në Librin e amzës të të lindurve, e që ka certifikatë nga Libri i posaçëm i amzës të të lindurve dhe dokument identifikimi sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me ligj”.

##### Neni 2

Në nenin 111, në paragrafin 1, fjalët “miratuar nga Komisioni i miratimit të programeve për edukim të vazhdueshëm profesional” zëvendësohen me fjalët “që e miraton pas mendimit profesional paraprak të Entit të Veprimtarisë Sociale”.

##### Neni 3

Me pagesën e ndihmës së garantuar minimale për muajt mars, prill dhe maj 2022, secilit përfitues të ndihmës së garantuar minimale do t'i paguhet shtesë të njëhershme në shumë prej 1.000,00 denarë për muajt mars, prill dhe maj 2022.

Pagesa e shtesës së njëhershme sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhet me mjetet e dedikuara për ndihmën e garantuar minimale.

##### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.